



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

JANAR 2022

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2022

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Juli.Lubonja@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore


- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Janar 2022, arriti në 105;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Janar 2022 ishte 3.7 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Janar 2022 ishte 107.32 lekë për dollarë dhe 121.49 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Janar 2022 shënuan kuotën 0.44 përqind për ato 12-mujore; 0.35 përqind për depozitat 6-mujore; 0.15 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.39 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.56 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.82 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.597.235 milionë lekë në muajin Janar, duke shënuar një rritje prej rreth 9.6 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2021 rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 271.57 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Janar 2022 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 13.13 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 7.92 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2022, arritën në rreth 45.73 miliardë lekë ose afërsisht 4.2% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 32.6 miliardë lekë ose rreth 9.4% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Janar 2022 ishte 3.7%, një vit më parë ky ndryshim ishte 0.4%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2022, krahasuar me Dhjetor 2021 është 1.3%. Një muaj më parë, Dhjetor 2021, IÇK shënoi rritje mujore prej 0.8%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Janar 2021 shënoi rritje mujore prej 1.3%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +6.7%, duke kontribuar me +2.35 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.7%.
- “Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +9.0%, duke kontribuar me +0.48 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.7%.

- “Komunikim”, me rritje vjetore +3.3%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.7%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” ka pësuar rritje vjetore të çmimit prej +3.0%, duke kontribuar me +0.12 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.7%.
- “Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +2.1%, duke kontribuar me +0.08 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.7%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2021	0.4	1.1	1.2	1.9	1.8	1.6	2.2	2.4	2.5	2.4	3.1	3.7
2022	3.7											

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Janar 2022, arriti në 121.49 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.57 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Janar, një euro u këmbye me 120.9 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Janar 2022 arriti në 107.32 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.43 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 108.18 lekë/dollarë.



Në krahasim me muajin Janar të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.65 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 5.63 përqind. Në përgjithësi, dobësimi i lekut në vitet e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.88 dollarë/euro për muajin Janar 2022.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Janar 2022, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.44 dhe 0.39 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.35 dhe 0.15 përqind përkatësisht.


Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.03 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan rënie mujore respektivisht me 0.04 dhe 0.03 pikë përqindje. Ndërkohë, normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore nuk patën ndryshim.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 1 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht prej 0.03 dhe 0.02 pikë përqindje. Ndërsa, normat e interesit të depozitave me afat 6 mujore kanë shënuar rritje prej 0.03 pikë përqindje, ndërsa ato 3 mujore nuk patën ndryshime krahasuar me një vit më parë.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Janar 2022, arritën përkatësisht kuotën prej 5.82 dhe 6.56 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 dhe 6 mujore kanë shënuar rritje përkatësisht me 0.63 dhe 0.56 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rënie vjetore me 0.29, ndërsa ato 6 mujore rritje me 0.26 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Janar 2022 patën rënie mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.02 dhe 0.34 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4





Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë


4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e tretë të vitit 2021, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv në rritje të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth 252.37 milionë euro. Për nëntëmujorin e parë të vitit 2021, defiçiti i llogarisë korente u ngushtua në -670.1 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -803.8 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, llogaria korente e ngushtoi deficitin në -116.6 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2020 që ishte -191.1 milion euro. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +703.2 milion euro krahasuar me +1,542.4 miliardë euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +231.9 mln euro, krahasuar me +135.3 mln euro në tremujorin e tretë të 2020. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +735.8 milionë euro ose +0.7%, krahasuar me +730.6 milion euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2021, IHD regjistruan vlerën +258.3 mln euro ose +8.0%, krahasuar me +239.2 mln euro në tremujorin e tretë të 2020. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën +1,473.7 miliardë euro, +101.4% (ose rreth 2 herë më shumë), krahasuar me +731.7 milion euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, ky zë regjistroi vlerën +786.5 mln euro, ose rreth 2.4 herë më shumë krahasuar me +323.2 mln euro në tremujorin e tretë të 2020.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Janar 2022, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 138.668 milionë lekë krahasuar me muajin Janar të vitit 2021. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 105.384 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 1 482 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 1.577 milionë lekë e Bankës Qëndrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,597.235 milionë lekë në muajin Janar 2022, duke shënuar një rritje prej rreth 140.420 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 9.6 përqind.

Gjithashtu në muajin Janar 2022, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 13,913 milionë lekë, ose me 0.9 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Janar 2022 arriti në rreth 664.671 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 58.388 milionë lekë, ose rritje me rreth 9.6 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (52.2%) dhe monedhave të huaja (47.8%).


Gjatë muajit Janar 2022, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 59.3 përqind ose 394.103 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.43 përqind ose rreth 235.467 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.2 dhe 2.05 përqind apo 21.254 dhe 13.634 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Janar 2022, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 70.1 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.17 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 1.99 dhe 3.75 përqind secili.




7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 362.840 milionë lekë në fund të muajit Janar 2022. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Janar 2022 ka shënuar rënie mujore prej 0.41 përqind dhe rënie vjetore prej 0.82 përqind, duke arritur nivelin 22.72 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.7 përqind, dhe rënie vjetore prej 1.39 përqind, duke shënuar nivelin 29.4 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Janar 2022, kanë shënuar rritje vjetore prej 84.471 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 76.1 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Janar 2022 shënuan rritje prej 35.996 milionë lekë në krahasim me muajin Janar 2021. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 78.5 përqind të depozitave në lekë.



8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Janar 2022, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 78.5 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 16.6 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.0 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 76.1 përqind dhe rreth 20.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 77.2 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 952,861 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (233.859 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (23.719 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (22.455 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.500 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Janar 2022, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.234.394 milionë lekë.

Fig-14



Përberja e depozitave Janar '22

Burimi: Banka e Shqipërisë


Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 17.312 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 120.467 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar 2022 janë mbledhur rreth 45.726 miliardë lekë të ardhura, për kundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 32.599 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 31.895 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 14.449 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 30.038 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 3.166 miliardë lekë (ose pothuajse e njëjtë me planin e periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 10.850 miliardë lekë (ose rreth 3.4% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 1.484 miliardë lekë (ose rreth 12.1% më shumë se plani për periudhën Janar 2022).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 31.895 miliardë lekë, 6.740 miliardë lekë (21.1% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 5.037 miliardë lekë (15.8%) për shpenzime interesi, 1.732 miliardë leke (5.4%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 74 miliardë lekë (0.23%) për subvencione, 14.449 miliardë lekë (45.3%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 2.457 miliardë lekë (7.7%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 1.407 miliardë lekë (4.4%) për shpenzimet e tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2022 ishin rreth 45.726 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 44.054 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 1.484 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar - Janar 2022 (mld Lekë) Revenues during January - January 2022 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Janar '22 Jan '22	Janar '21 Jan '21	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	15.075	11.205	+34.5
	Taksa doganore (Custom Tax)	464	375	+23.7
	Akcizat (Excise)	3.495	3.185	+9.7
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	1.652	1.553	+6.4
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	4.028	3.382	+19.1
	Taksat nacionale (National Tax)	5.324	3.394	+56.9

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Janar - 2022

Source: Ministry of Finance and Economy, Fiscal Statistics: January - 2022

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 13.127 miliardë lekë gjatë periudhës Janar 2022, u përdor kryesisht për financim të brendshëm.

Për periudhën Janar-Janar 2022, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 45.726 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 32.599 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Janar 2022, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 44.054 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 31.895 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 14.449 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Indeksi i çmimeve të konsumit
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)							Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	3.7	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1		1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2		0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1		February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7		0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0		0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2		March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2		0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8		0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9		April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9		0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5		0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8		May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8		0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3		1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.1		0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2		1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	2.2		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.4		0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	2.4		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.5		0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	2.5		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2	0.1		0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	2.0	2.4		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5	0.2		0.12	0.1	0.1	0.0	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.6	3.1		November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3	0.8		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1	3.7		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	Currency
Mesatarja e periudhës									Average of period
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	103.68	107.32	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	122.37	121.49	EURO
Fundi i periudhës									In the end of period
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	106.54	108.18	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	120.76	120.90	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	In percent
Norma e depozitave			Deposits rates			
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.44	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.35	0.35	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.39	1-M
Norma e huasë			Lending rates			
12-M	5.66	6.25	6.05	5.91	6.56	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	6.16	5.82	6-M
Norma e letrave me vlerë			Securities rates			
Bono thesari 1/						Treasury bills 1/
3-M	-	-	-			3-M
6-M	-	-	-			6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.60	1.58	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	45,726	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	189	Grants
II.	Të ardhura tatimore	44,054	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	30,038	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	15,075	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,652	Profit Tax
3	Akcizat	3,495	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	4,028	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	5,324	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	464	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	3,166	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	277	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	9	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	2,880	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	10,850	Social Ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	9,312	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,500	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	38	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,484	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	942	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	188	Utility fees
4	Të tjera	354	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,599	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,895	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,740	Personnel expenditures
1	Paga	5,781	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqerore	952	Social insurance contributions
3	Arsimi i larte nga te ardhurat e veta	6	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,037	Interest
1	Të Brendshme	4,010	Domestic
2	Të Huaja	1,027	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,732	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	14,449	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqerore	10,645	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,129	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	674	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,457	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,407	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	45	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,162	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	200	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	703	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Lartë	1	From higer education system's own revenues
3	Financimi Huaj	703	Foreign financed
IV	Fondi i rindertimit	0	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	13,127	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-13,127	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-12,150	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	44	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,604	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,798	Others
V.3	I huaj	-977	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	420	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	114	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,511	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2022

Table of investments 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Janar		
January		
Financim i brendshëm	-12,150	Domestic financing
<i>Në %</i>	92.6	<i>In %</i>
Financim i huaj	-977	Foreign financing
<i>Në %</i>	7.4	<i>In %</i>
Totali	-13,127	Total
<i>Në %</i>	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2022
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2022**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	
	January	
Taksë doganore	464	Customs Duties
TVSH	9,160	V.A.T
Akcizë	3,495	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	277	Others (Mineral Rent)
TOTALI	13,397	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2022 (TAX REVENUE)

TVSH	5,915	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,652	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	4,028	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	5,047	National taxes
TOTALI	16,641	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	30,037	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2022*The Deficit and Its Financing for 2022**Të dhëna progresive (Progresive Data)**Në milionë lekë (In million ALL)*

	Janar January	
TË ARDHURAT	45,726	REVENUE
SHPENZIMET	32,599	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	13,127	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-13,127	FINANCING
Financimi i brendshëm	-12,150	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	44	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	2,604	Domestic borrowing
Të tjera	-14,798	Others
Financimi i jashtëm	-977	Foreign
a. Hua afatgjatë	420	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	114	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,511	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore		Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë**Source:** Ministry of Finance and Economy

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	2017	2018	2019	2020	Q1_2021	Q2_2021	Q3_2021	
Llogaria korente	-865.90	-866.40	-1,088.70	-1,155.90	-309.00	-243.23	-116.49	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,824.10	-2,871.10	-3,143.80	-2,982.50	-752.00	-855.14	-997.88	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	797.10	986.10	906.50	793.60	263.90	337.70	306.08	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,621.20	-3,857.20	-4,050.30	-3,776.10	-1,015.90	-1,192.84	-1,303.96	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,081.90	1,111.00	1,263.90	1,056.20	270.30	445.38	647.45	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,856.20	3,072.80	3,404.60	2,230.70	582.60	842.61	1,199.50	Services Credit
Shërbimet Debi	1,774.30	1,961.80	2,140.70	1,174.50	312.30	397.23	552.05	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	28.60	-13.80	-180.10	-227.00	-75.60	-87.02	-49.78	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	407.40	392.80	420.20	337.10	69.80	71.85	94.23	Income Credit
Të ardhurat Debi	-378.80	-406.60	-600.30	-564.10	-145.40	-158.87	-144.01	Income Debt
Bilanci i transfertave	847.70	907.50	971.30	997.40	248.30	253.55	283.72	Balance of Transfers
Transferta private	961.80	1,005.40	1,105.50	1,169.70	286.50	293.83	327.50	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	-114.10	-97.90	-134.20	-172.30	-38.20	-40.28	-43.78	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	122.30	104.00	76.10	143.60	98.00	48.76	96.27	Capital Account
Llogaria financiare	-1,115.30	-1,142.60	-827.00	-1,507.20	-326.50	-17.79	-135.64	Financial Account
Investime direkte	-993.80	-1,022.20	-1,036.30	-892.00	-217.80	-225.09	-240.31	Direct Investment
Investime portofoli	-100.00	-76.10	140.60	-70.30	111.80	78.86	143.93	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	49.00	-50.40	50.90	-403.80	-233.80	118.07	-58.47	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	-186.30	-8.70	107.90	159.60	-41.00	59.41	136.95	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	185.40	371.50	-77.70	654.50	74.50	-117.27	252.37	Overall Balance
Rezervat	185.40	371.50	-77.70	654.70	74.50	-117.27	271.57	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	70.50	-6.10	-17.80	141.10	-13.30	-10.37	-19.21	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2018	2019	2020	2021	2022		Millions of Lek End of Period
					Janar January		
Mjete valutore neto	724,363	733,114	803,487	937,814	939,296		Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	786,907	794,006	860,750	1,027,069	1,031,821		Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	62,544	60,892	57,263	89,255	92,525		Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	874,968	950,426	1,047,835	1,084,106	1,088,115		Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	340,781	378,524	435,613	412,253	417,768		Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve të tjera	534,187	571,902	612,221	671,852	670,346		Claims on other sectors
Detyrimet e parashë së gjërë	1,264,127	1,318,662	1,456,993	1,582,310	1,597,235		Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	275,285	291,409	344,560	366,251	362,841		Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	375,047	408,780	490,394	584,631	598,282		Transferable deposits
Depozita të tjera	613,795	618,473	622,039	631,428	636,112		Other deposits
Depozita të përfshira në parashë së gjërë	148,927	178,375	186,892	222,409	215,455		Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike					0		Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,092	3,879	4,666	5,877	5,937		Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	376	336	252	392	394		Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,399	8,238	6,925	16,599	8,750		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	139,061	165,922	175,050	199,541	200,374		Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,183	6,656	5,926	7,288	6,910		Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	164	101	57	67	26		Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	6,019	6,555	5,869	7,221	6,884		Other resident sectors
Huatë	2,838	2,527	3,757	3,507	3,476		Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike					0		Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,838	2,527	3,757	3,507	3,476		Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike					0		Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare					0		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë					0		other resident sectors
Llogari të pagueshme	285	229	62	248	336		Accounts payable
Korporata të tjera Financiare					0		Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike					0		Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	1	1	5		0		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	284	229	57	247	336		other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	188,868	200,257	214,394	219,725	220,474		Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-6,266	-2,652	-1,095	-5,442	-5,468		Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,300	-23,895	-17,621	-14,428	-17,843		Other items net
Detyrime të tjera	61,547	50,220	55,892	59,094	56,797		Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,847	74,115	73,514	73,521	74,640		Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	403	729	919.0	862	1,369		Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	532,818.6	570,792.2	608,779.8	666,178.4	664,671.0	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën	682.6	560.6	429.1	313.2	212.9	Credits to local Government
Në lekë	682.6	560.6	429.1	313.2	212.9	in Lek
Në valutë	-	-	-	0.0	0.0	in Foreignn Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	20,270.0	24,182.4	15,150.8	22,521.8	21,254.4	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	16,594.1	18,489.7	11,819.6	9,210.6	9,358.1	in Lek
Në valutë	3,675.9	5,692.7	3,331.2	13,311.3	11,896.3	in Foreignn Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	317,578.4	335,884.5	370,356.3	395,162.7	394,103.4	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	127,739.6	141,240.5	161,975.3	172,000.2	171,500.7	in Lek
Në valutë	189,838.8	194,644.1	208,381.0	223,162.5	222,602.7	in Foreignn Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	10,164.0	13,555.1	13,169.1	13,815.7	13,633.5	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	4,802.1	8,023.8	7,489.2	7,772.8	7,326.9	in Lek
Në valutë	5,361.9	5,531.3	5,679.9	6,043.0	6,306.7	in Foreignn Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	184,123.6	196,609.5	209,674.5	234,365.0	235,466.9	Credits to other resident sectors
Në lekë	118,934.6	130,409.2	138,986.4	158,093.0	158,725.6	in Lek
Në valutë	65,189.0	66,200.3	70,688.1	76,272.0	76,741.2	in Foreignn Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

OFERTA E PARASË*Money Supply***Mujor-Monthly**

Në milion Lekë	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	Millions of LEK End of Period
Fundi i periudhës						
Baza monetare	423,428	433,951	534,347	565,163	557,155	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	275,285	291,409	344,560	366,251	362,841	Currency outside depository corporations
Agregati M1	478,721	523,968	637,317	701,404	699,228	M1 Aggregate
Agregati M2	731,502	758,022	862,338	918,474	915,120	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	Millions of Leks End of Period
Totali i depozitave	988,842	1,027,253	1,112,433	1,216,059	1,234,394	Total of deposits
Në lekë	456,217	466,613	517,778	552,223	552,279	In national currency
Depozitat e transferueshme	169,425	190,538	241,316	276,074	275,246	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,482	1,624	1,644	1,302	1,430	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	8,662	10,667	13,747	17,118	13,343	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	2,570	3,694	3,666	4,744	4,683	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	47,156	49,099	66,074	77,758	80,228	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	109,555	125,454	156,185	175,154	175,560	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	34,012	42,021	51,442	59,079	61,142	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike						Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	199	120	166	1,762	2,772	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	16	87	131	78	78	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,066	2,873	3,970	3,554	3,990	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	31,730	38,942	47,175	53,686	54,302	Other resident sectors
Depozita të tjera	252,781	234,053	225,021	217,070	215,892	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	13	10	10			Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,635	709	1,465	757	603	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,051	4,147	4,868	5,136	4,168	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	9,687	7,978	6,836	7,598	7,342	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	236,395	221,210	211,841	203,579	203,779	Other resident sectors
Në valutë	532,625	560,640	594,655	663,836	682,115	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	205,623	218,241	249,078	308,556	323,036	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	113	158	82	39	70	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,355	2,688	2,246	2,465	3,309	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,616	5,360	6,742	6,143	6,699	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	75,861	79,001	90,281	116,544	124,501	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	124,676	131,036	149,726	183,366	188,457	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	83,610	106,417	120,699	136,407	137,737	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike						Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	53	136	97	94	87	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	0	1	1	10	0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,194	2,786	5,845	3,739	3,857	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	81,363	103,495	114,755	132,565	133,792	Other resident sectors
Depozita të tjera	243,393	235,982	224,878	218,873	221,342	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike				24	0	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,696	1,522	1,732	1,519	2,341	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,598	7,058	6,939	8,936	8,092	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,814	11,662	10,854	12,622	13,941	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	226,284	215,741	205,353	195,771	196,969	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 Tregues të shëndetit financiar (FSI)
(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)
(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Jan 2021	Shk 2021	Mar 21	Prill 21	Maj 21	Qer 21	Korr 21	Gueh 21	Shtat 21	Tet 21	Nën 21	Dhje 21	Jan 22	Index description
Tregues me bazë kapitalin														Capital-based
Kapitali rregulator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	0.00	18.10		0.00		17.95	0.00	0.00	18.30			18.00	0.00	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregulator (miliard lekë)		155,923				158,486			164,622			167,215		Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (miliard lekë)		861,258				883,172			899,548			928,994		Risk-weighted assets
Kapitali rregulator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)		0.00	17.00	0.00		16.93	0.00	0.00	17.16			16.89	0.00	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve														Capital as a percent of total assets
Kapitali rregulator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.91	8.86	9.13	9.16	9.16	9.09	9.09	9.12	9.00	9.00	9.00	8.85	8.88	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregulator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.48	9.41	9.73	9.74	9.73	9.63	9.66	9.67	9.60	9.59	9.60	9.43	9.46	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.34	10.37	10.42	10.11	10.09	10.13	10.06	9.97	9.99	10.03	10.05	9.91	10.00	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit (në %)														Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit rregulator të nivelit I (në %)	11.28	11.55	10.70	10.56	10.50	9.57	9.35	9.15	8.34	8.51	8.46	7.59	7.73	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit rregulator (në %)	10.61	10.87	10.05	9.92	9.89	9.03	8.79	8.63	7.82	7.98	7.93	7.13	7.26	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit aksioner (në %)	9.72	9.87	9.38	9.57	9.54	8.58	8.45	8.37	7.51	7.63	7.58	6.78	6.87	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	11.64	11.58	11.68	11.97	11.57	12.80	11.73	12.03	12.83	12.77	12.50	12.89	6.48	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)														Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregulator të nivelit I (në %)	7.44	7.70	8.21	4.05	4.87	4.81	7.35	7.65	8.22	8.07	9.26	9.80	6.68	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregulator (në %)	7.00	7.24	7.71	3.81	4.59	4.54	6.92	7.21	7.71	7.57	8.68	9.20	6.27	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	6.41	6.57	7.20	3.67	4.43	4.32	6.65	7.00	7.41	7.24	8.29	8.75	5.93	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivitet														Asset-based indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	34.92	34.25	33.70	32.85	34.09	34.13	34.33	33.65	33.42	32.69	32.32	33.28	34.40	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	13.42	12.61	11.68	11.16	12.32	12.77	12.66	13.66	13.42	12.67	12.19	13.29	13.15	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	47.45	46.72	45.87	44.67	46.16	46.51	46.84	46.11	45.88	44.79	44.51	45.39	46.72	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	18.24	17.20	16.31	15.17	16.69	17.40	17.27	18.72	18.42	17.36	16.79	18.12	17.85	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivitet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.37	1.29	1.25	1.28	1.26	1.38	1.27	1.30	1.40	1.39	1.34	1.42	0.71	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	8.20	8.15	7.96	7.88	7.80	7.12	7.05	6.96	6.49	6.35	6.20	5.65	5.45	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve														Income and expense-based
Margjisi i interesave ndaj të ardhurave bruto	72.98	76.32	76.43	74.92	74.89	73.61	74.74	74.34	73.91	74.11	74.85	73.96	89.03	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	52.50	58.37	58.67	58.40	58.53	57.27	58.38	58.17	57.97	58.25	59.36	60.25	65.60	Noninterest expenses to gross income
Të tjera														Other
Numri i bankave	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	Number of banks

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania